



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.855/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Blerta Halimi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.855/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Blerta Halimi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Blerta Halimi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në vendvotimin në shkollën fillore “Meto Bajraktari” në Prishtinë kam dëshmi se mungojnë një numër i madh i votave pas certifikimit të rezultateve në atë vendvotim kam vetëm 10 vota. Gjithashtu në fshatin Keqekollë e cila ka vetëm një vendvotim, në bazë të rezultateve të KQZ-së, aty nuk figuron asnjë votë edhe pse kam familjar dhe shoqëri që dëshmojnë votën.

Si dëshmi ka bashkangjitur disa biseda në rrejte sociale.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Blerta Halimi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në

Prishtinë, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet: shkolla fillore “Meto Bajraktari” dhe vendvotimin në fshatin Keqkollë.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.855/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhafi**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.